



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr.3113/7 prot.

Datë 18.11.2025

V E N D I M
Nr. 1700/2025

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Fiorent Zguro	Nënkryetar
Anila Malaj	Anëtar
Gjergj Mersini	Anëtar

Në mbledhjen e datës 18.11.2025 shqyrtoi ankesën me:

Objekt: Anulim i shortit të datës 23.10.2025 për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-59440-08-27-2025, me objekt: “Blerje Hipoklorit Kalciumi”, me fond limit 4 940 000 (katër milion e nëntëqind e e dyzet mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat sh.a.

Ankimues: Operatori ekonomik “2 AT” SHPK me NIPT. K14019001H dhe adresë Korçë-Dishnicë.

Autoriteti Kontraktor: Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Berat sh.a. Lagja nr 1, Objekti Nr 7, Rruga Antipatrea, Berat.

Subjekte të interesuar: Operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK me Nipt M11815028I dhe adresë: Rruga e Kavajës, Buka SH.A, Nr.8240, Njësia Nr.6, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:**I***Vlerësimi paraprak*

I 1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është nën kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga 3 (tre) anëtarë, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II*Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 28.08.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-59440-08-27-2025, me objekt: “Blerje Hipoklorit Kalciumi”, me fond limit 4 940 000 (katërmilion e nëntëqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat sh.a..

II.2. Në datën 08.09.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.3. Në datën 18.09.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “2 AT” SHPK	3 705 000	lekë kualifikuar
2. “Albania Distribution Chemicals” SH.P.K	3 705 000	lekë s’kualifikuar
3. “ATLANTIK 3” SHPK	0	lekë s’kualifikuar.

II.4. Në datën 19.09.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraparak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor u depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5839, datë 21.09.2025 dhe me Nr. 2573/2025 Prot., datë 22.09.2025 e operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

II.6. Në datë 15.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1449/2025, ku vendosi:

[.....]

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “ Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-59440-08-27-2025, me objekt: “Blerje Hipoklorit Kalciumi”, me fond limit 4 940 000 (katërmilion e nëntëqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat sh.a*

2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomikë ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, duke e kualifikuar atë.*

3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK.
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
 6. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. [...]

II.7. Në datën 20.10.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet SPE në rubrikën “Mesazhe” ka njoftuar operatorin ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK dhe operatorin ekonomik “2 AT” SHPK për hedhjen e shortit, me qëllim përcaktimin e ofertës fituese.

II.8. Më datë 23.10.2025 autoriteti kontraktor nëpërmjet SPE në rubrikën “Mesazhe” ka njoftuar operatorin ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK mbi paraqitjen e dokumentacionit fizik në përputhje me pikën 6 të nenit 26 të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar, dokumentacion i cili duhet të dorëzohet brenda datës 27.10.2025, ora 16:00 në përputhje me nenin 83 pika 2 të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar

II.9. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 30.10.2025 është publikuar njoftimi i fituesit paraprak të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.10. Në datën 31.10.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/6031 dhe me numer 3113/2025 prot, datë 03.11.2025 e operatorit ekonomik “2 AT” SHPK për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-59440-08-27-2025, me objekt: “Blerje Hipoklorit Kalciumi”, me fond limit 4 940 000 (katër milion e nëntëqind e e dyzet mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a..

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me veprimet proceduriale të autoritetit kontraktor në lidhje me shortin e mbajtur për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

II.11. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. 3113/1 prot., datë 04.11.2025.

II.12. Nëpërmjet shërbimit shkresës nr.912/32 prot., datë 07.11.2025, (tw ardhur nwpwrmjet sistemit elektronik) protokolluar me tonën me nr.3113/3 prot., datë 10.11.2025, dhe nr. 3113/4, datw 10.11.2025 (ardhur nwpwrmjet shwrbimit postar) autoriteti kontraktor ka përcjellë pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacion mbi procedurën e prokurimit objekt ankimi, , procesverbalin e hedhjes së shortit nr. 912/24 prot., datë 23.10.2025, si dhe aktin e trajtimit të ankesës, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues “2 AT ” SHPK.

II.13. Referuar aktit të trajtimit të ankesës nr.3113/2025 prot., datë 03.11.2025, rezulton se autoriteti kontraktor ka trajtuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues “2 AT” SHPK dhe në përfundim ka vendosur refuzimin e saj.

II.14. Nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike operatori ekonomik i interesua “Albania Distribution Chemicals” SHPK, ka paraqitur formularin e paraqitjes se argumentave, në përputhje me nenin 113 të LPP-së pas marrjes dijeni për aktin e trajtimit të ankesës, formular i cili është protokolluar me tonën me nr.3113/2 prot., datë 06.11.2025.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dhe dokumentacionit bashkëngjitur saj,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “2 AT” SHPK mbi anulimin e shortit të datës 23.10.2025, ora 10.00 për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyen se: *“Njoftimi për hedhjen e shortit duhet të bëhet vetëm pasi të ketë përfunduar faza e heqjes të pezullimit dhe lejimit me hapat e mëtejshme, çka përbën shkelje të procedurës”,* Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në datën 28.08.2025, në Sistemin e Prokurimeve Elektronike është publikuar procedura e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-59440-08-27-2025, me objekt: “Blerje Hipoklorit Kalciumi”, me fond limit 4 940 000 (katërmilion e nëntëqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a..

III.1.2. Në datën 08.09.2025 autoriteti kontraktor zhvilloi procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

III.1.3. Në datën 18.09.2025, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “2 AT” SHPK	3 705 000	lekë kualifikuar
----------------	-----------	------------------

2. “Albania Distribution Chemicals” SH.P.K	3 705 000	lekë s’kualifikuar
3. “ATLANTIK 3” SHPK	0	lekë s’kualifikuar.

III.1.4. Në datën 19.09.2025, autoriteti kontraktor ka publikuar në Sistemin e Prokurimit Elektronik “Publikimi i Njoftimit të Fituesit Paraprak” për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

III.1.5. Nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe Autoritetit Kontraktor u depozituar ankesa me numër ankimimi elektronik A/2025/5839, datë 21.09.2025 dhe me Nr. 2573/2025 Prot., datë 22.09.2025 e operatori ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK, ku u konstatua se objekti i saj lidhet me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi skualifikimin e ofertës së tij nga procedura e prokurimit të sipërcituar.

III.1.6. Në datë 15.10.2025, Komisioni i Prokurimit Publik mori vendimin Nr. 1449/2025, ku vendosi:

[.....]

1. *Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK në procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-59440-08-27-2025, me objekt: “Blerje Hipoklorit Kalciumi”, me fond limit 4 940 000 (katërmilion e nëntëqind e dyzet mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjiellës Kanalizime Berat sh.a*
2. *Autoriteti kontraktor të anulojë vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e operatorit ekonomikë ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK, duke e kualifikuar atë.*
3. *Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.*
4. *Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Albania Distribution Chemicals” SHPK.*
5. *Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.*
6. *Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.*

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë. [...]

III.1.7. Në datën 20.10.2025, autoriteti kontraktor nëpërmjet SPE në rubrikën “Mesazhe” ka njoftuar operatorin ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK dhe operatorin ekonomik “2 AT” SHPK për hedhjen e shortit, me qëllim përcaktimin e ofertës fituese.

III.1.8. Më datë 23.10.2025 autoriteti kontraktor nëpërmjet SPE në rubrikën “Mesazhe” ka njoftuar operatorin ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK mbi paraqitjen e dokumentacionit fizik në përputhje me pikën 6 të nenit 26 të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar,

dokumentacion i cili duhet të dorëzohet brenda datës 27.10.2025, ora 16:00 në përputhje me nenin 83 pika 2 të Vendimit nr. 285, datë 19.05.2021, të ndryshuar

III.1.9. Referuar sistemit të prokurimit elektronik rezulton, se më datë 30.10.2025 është publikuar njoftimi i fituesit paraparak të procedurës së mësipërme të prokurimit.

III.1.10. Në datën 31.10.2025 nëpërmjetë sistemit të ankesave elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoritetit kontraktor, është administruar ankesa me nr. elektronik A/2025/6031 dhe me numer 3113/2025 prot, datë 03.11.2025 e operatorit ekonomik “2 AT” SHPK për procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-59440-08-27-2025, me objekt: “Blerje Hipoklorit Kalciumi”, me fond limit 4 940 000 (katër milion e nëntëqind e e dyzet mijë) lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjellës Kanalizime Berat sh.a..

Nga shqyrtimi paraparak i ankesës të sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me veprimet procedurale të autoritetit kontraktor në lidhje me shortin e mbajtur për procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi.

III.1.11. Në nenin 2 “Qëllimi i ligjit” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet se: Qëllim i këtij ligji është: a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik; b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik; ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë; d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik; dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Ndërsa në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr. 162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se 1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.

III.1.12. Në pikën 6 të nenit 82 “Shqyrtimi dhe vlerësimi i ofertave” të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet se;

“6. Nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin çmim më të ulët ose kanë pikë të njëjta, atëherë fituesi do të përcaktohet me short, në prani të ofertuesve. Njoftimi për datën dhe orën e hedhjes së

shortit u njoftohet ofertuesve. Mospjesëmarrja e ofertuesve gjatë procesit të hedhjes së shortit nuk përbën shkak për skualifikim”.

III.1.13. Në pikën 4.1 “*Vlerësimi i ofertave bazuar në metodën e paracaktuar të vlerësimit*”, të udhëzimit nr.07, datë 30.07.2021 “*Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike*”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

“...Kujdes: Nëse anëtari i KVO konstaton se, janë paraqitur oferta ekonomike në vlerë të barabartë atëherë duhet të ndiqen parashikimet ligjore për hedhjen e shortit ndërmjet operatorëve ekonomikë, të cilët kanë rezultuar me vlerë ekonomike të njëjtë.

Anëtari i KVO tek skedari “Vlerësuar” përzgjedh procedurën e prokurimit duke klikuar dy herë dhe në dritaren që shfaqet, klikon tek skedari “Ofertat e Paraqitura” dhe më pas, duhet t’i dërgojë një mesazh me anë të butonit “Kërkesë e Re” të gjithë operatorëve ekonomikë, të cilët kanë rezultuar me vlerë ekonomike të njëjtë, pasi të jetë përfunduar në sistem faza “Vlerësimi i Ofertave” nga nëpunësi i autorizuar i njësisë...”.

III.1.14. Në interpretim të sa më sipër KPP gjykon se, pasi të ketë përfunduar në sistem faza “*Vlerësimi i ofertave*”, nëse dy ose më shumë oferta kanë të njëjtin cmim, autoriteti kontraktor ka detyrimin të njoftojë operatorët ekonomikë, të cilët kanë paraqitur oferta ekonomike në vlerë të barabartë, për hedhjen e shortit, me qëllim përcaktimin e fituesit. Në rastin konkret, KPP vëren se, autoriteti kontraktor në zbatim të vendimit nr.1449/2025, datë 15.10.2025 të Komisionit të Prokurimit Publik ka bërë rivlerësimin e ofertave duke kualifikuar operatorin ekonomik “Albanian Distribution Chemical” SHPK i cili rezulton të ketë ofertuar me të njëjtën vlerë me operatorin ekonomik “2 AT” SHPK , konkretisht 3,705,000 lekë pa tvsh. Nëpërmjet rubrikës “*Mesazhe*” në sistemin e prokurimit elektronik, në datën 20.10.2025, ora 13:32 ka njoftuar operatorët ekonomikë të cilët kanë ofertuar me vlerë të njëjtë për hedhjen e shortit, me qëllim përcaktimin e ofertës fituese, duke përcaktuar si datë të hedhjes së shortit datën 23.10.2025, ora 10.00. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor, procesverbalit për hedhjen e shortit datë 23.10.2025, KPP konstaton se në datën 23.10.2025, ora 10.00, autoriteti kontraktor ka realizuar hedhjen e shortit. Referuar sistemit të prokurimit elektronik, KPP konstaton se në datën 23.10.2025, ora 11:36 autoriteti kontraktor ka përfunduar fazën “*Ri-Vlerësimi i ofertave*”.

Në rastin konkret, KPP vëren se, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë, të cilët kanë ofertuar me vlerë të njëjtë, për hedhjen e shortit pas përfundimit të vlerësimit të ofertave, veprim ky i kryer në përputhje me përcaktimin e bërë në rregullat prokurimit publik dhe udhëzimin nr.07, datë 30.07.2021 “*Për mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit me mjete elektronike*”, i ndryshuar dhe vendimit nr.1449/2025, datë 15.10.2025. Ky udhëzim përcakton qartë që njoftimi për hedhjen e shortit duhet të bëhet vetëm *pasi të ketë përfunduar faza “Vlerësimi i Ofertave”* në sistemin e prokurimit elektronik. Në rastin konkret, njoftimi për shortin është bërë në datën 20.10.2025, në bazë të vendimin nr.1449/2025, datë 15.10.2025 të KPP i cili ka

përcaktuar qartë që autoriteti kontraktor duhet të bëjë rivlerësimin e procedurës së prokurimit duke kualifikuar operatorin ekonomik “2 AT” SHPK dhe të njoftojë KPP për zbatimin e këtij vendimi, ndërkohë që faza “Vlerësimi i Ofertave” ka përfunduar më 23.10.2025, pra njoftimi është bërë pas përfundimit zyrtar të vlerësimit të ofertave, çka nuk përbën shkelje të procedurës. Heqja e pezullimit nuk ka si të bëhet nëse këto veprime nuk kryhen dhe nuk dokumentohen nga autoriteti kontraktor dhe vetëm mbasi të jenë kryer të gjitha këto KPP vendos heqjen e pezullimit të procedurës. Pra, nga sa më sipër rezulton se autoriteti kontraktor ka ndjekur hapat proceduralë të parashikuar në rregullat e prokurimit publik për hedhjen e shortit për shpalljen e ofertës fituese. Komisioni i Prokurimit Publik thekson faktin, se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LPP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike.

KPP gjykon se veprimi i autoritetit kontraktor për hedhjen e shortit pasi ka përfunduar vlerësimin e ofertave nuk paraqet shkelje të parimit të barazisë së trajtimit të ofertuesve dhe nuk krijon një perceptim të paragjykitimit dhe mungesës së transparencës në procedurë.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “2 AT” SHPK *për skualifikimin e operatorin ekonomik “Albania Distribution Chemicals” sh.p.k me argumentimin se dokumentacioni i paraqitur nga Albania Distribution Chemicals sh.p.k. është i pasaktë dhe të kërkohej verifikim zyrtar pranë ECHA/REACH dhe tek kompania “Cargochem Adria d.o.o.”*, nëse është vërtet prodhuese e produktit Hipoklorit Kalciumi”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në nenin 24, pika 1, “Komisioni i prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, parashikon shprehimisht se: *“Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”*.

III.2.2. Në nenin 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.”*

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik në Sistemin Elektronik të Ankesave”.

III.2.3. Në nenin 111, pika 1, të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: *“1. Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.*

III.2.4. Neni 113 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se:

1. Në rastet e ankesave për vendimet e autoritetit ose entit kontraktor për përzgjedhjen e kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, operatorët ekonomikë, të cilët kanë marrë pjesë në procedurën e prokurimit dhe mund të cenohen nga ankesa e paraqitur, kanë të drejtë të paraqesin argumentet e tyre në lidhje me këtë të fundit njëkohësisht pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, afati kohor për paraqitjen e këtyre argumenteve është 7 ditë nga publikimi i ankesës nga Komisioni i Prokurimit Publik. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 5 ditë.

Paraqitja e argumenteve bëhet në Sistemin e Ankesave Elektronike.

2. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumente që kundërshtojnë ankesën, sipas parashikimeve të pikës 1 të këtij neni, nuk mund të ushtrojnë më pas të drejtën e ankimit për vendimin e dhënë në lidhje me ankesën për këtë procedurë prokurimi.

III.2.5. Në nenin 94 pika 1 të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, parashikohet:

1. Çdo operator ekonomik, i cili ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi sipas LPP, dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga veprimet ose mosveprimet e autoritetit/entit kontraktor, për të cilat pretendon se janë në kundërshtim me ligjin, ka të drejtë të ankohet pranë autoritetit/entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

III.2.6. Neni 51 i Vendimit Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, parashikon shprehimisht se:

“Komisioni zhvillon mbledhjen për shqyrtimin paraprak të ankesës nga ana formale, në të cilën verifikon:

a. juridiksionin administrativ dhe kompetencën lëndore të Komisionit;

b. legjitimitimin e ankuesit;

c. respektimin e afateve ligjore për ankimin;

d. elementet e domosdoshme të ankesës të parashikuara në pikën 2 të nenit 48 të kësaj rregulloreje.”

III.2.7. Komisioni i Prokurimit Publik, gjen me vend të sqarojë, se me hyrjen në fuqi të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, një ndër elementet e ndryshimit thelbësor material dhe procedural ishte ai i procedurave të ankimit. Kështu, referuar parashikimeve të nenit 110 të ligjit u parashikua se *“Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit. Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë”*.

Për një interpretim të drejtë dhe qëllimor të normave të ligjit, mund t’i referohemi edhe metodës së interpretimit sistematik (Interpretimi sistematik vërteton domethënien e drejtë të normës juridike duke e lidhur me normat e tjera brenda sistemit juridik. Kjo do të thotë se norma juridike s’mund të interpretohet si e vetme, e ndarë prej normave të tjera juridike, si dhe metodës së interpretimit qëllimor (teologjik), i cili mundëson kuptimin e normës ligjore sipas objektivave të krijimit të tij, por edhe historik, mbi arsyet se përse lindi nevoja e ndryshimeve të procedurave të ankimit të ligjit.

Referuar relacionit të miratimit të ligjit nr. 162/2020 ndër të tjera është sqaruar se *“Ankimi i operatorëve ekonomikë, njëkohësisht si në autoritetin kontraktor, edhe në Komisionin e Prokurimit Publik, duke shkurtuar procesin e rishikimit administrativ i afateve të ankimit”*.

Pra, sistemi i ankimit njeh të drejtën e ankimit një herë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe autoriteteve kontraktore në rast se operatorët ekonomikë gjykojnë, se për shkak të vendimmarrjes së autoritetit kontraktor janë cenuar të drejtat e tyre.

Ndërkohë, ligjvënësi ka parashikuar edhe të drejtat e subjektit të interesuar në procedurën e prokurimit në përputhje me nenin 113 të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar. Përdorimi i instrumentit të ankimit nga subjektet e interesuara të cilat kanë paraqitur argumente lidhet me dy momente referuar ligjit të prokurimit publik, atë të paraqitjes së ankesës drejtpërdrejtë në KPP referuar nenit 114 pika 5 të ligjit në rast se ankesa është pranuar nga ana e autoritetit kontraktor dhe ankimit në gjykatë referuar nenit 121 të ligjit për prokurimin publik, në rast të vendimmarrjes së Komisionit të Prokurimit Publik.

Referuar ligjit të prokurimit publik, në rastin konkret paraqitja e argumenteve të subjekteve të interesuara për ligj të drejtën e operatorëve ekonomikë për të paraqitur ankesë në lidhje me plotësimin ose jo të kritereve të veçanta të kualifikimit apo specifikimeve teknike nga operatorë të

tjerë ekonomike për të cilët ata shfaqin pretendime pasi njihen me vendimarrjen e autoriteti kontraktor për trajtimin e ankesës vetëm mbi argumentet që kanë paraqitur në formularin përkatës dhe jo me pretendime shtesë si në rastin konkret. Operatori ekonomik ankimues ka marrë dijeni mbi arsyet e plota të skualifikimit të operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK përmes aktit të publikimit të njoftimit të fituesit paraprak për të cilin nuk ka paraqitur argumente apo ankesë mbi këto argumente. Për cdo pretendim tjetër që lidhet me arsyet e skualifikimit apo shtimin e arsyeve të skualifikimit, ka patur në dispozicion momentin procedural të paraqitjes së ankesës në përputhje me nenin 110 të LPP. Komisioni i Prokurimit Publik, thekson faktin se përcaktimi i procedurave dhe afateve të caktuara procedurale në LLP dhe Rregullat e Prokurimit Publik, duke filluar nga afati për përgatitjen e ofertës, afati i shqyrtimit të ofertave, afati i ankimit etj, përfaqësojnë garanci dhe siguri juridike për palët e interesuara. Parimi i ligjshmërisë është ndër parimet kryesore të veprimtarisë së organeve të administratës publike. Gjithashtu, ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurave të prokurimit, parashikuar nga lex specialis LPP, në nenin 2 të tij, janë ato të mosdiskriminimit, transparencës dhe barazisë. Tërësia e elementeve të mësipërme lidhet ngushtësisht me elemente të ligjshmërisë së vendimeve të organeve të administratës publike. Gjithashtu, KPP gjykon, se ligjvënësi ka parashikuar afate strikte kohore për zhvillimin e procedurave të prokurimit në përgjithësi dhe në veçanti në lidhje me institutin e ankimit administrativ, të rishikimit të vendimarrjes së autoritetit kontraktor. Në këtë kuadër referuar arsyetimit më sipër, KPP gjykon se pretendimet mbi skualifikimin dhe shtimi i arsyeve të skualifikimit të operatorit ekonomik “Albania Distribution Chemicals” SHPK të paraqitura nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK nuk do të merren në shqyrtim për shkak se për arsyet shtesë të skualifikimit duhet të paraqitej ankesë në përputhje me afatet ligjore të parashikuara në nenin 110 të LPP-së.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “2 AT” SHPK në procedurën e prokurimit “E Hapur e Thjeshtuar”, me Nr. REF-59440-08-27-2025, me objekt: “Blerje Hipoklorit Kalciumi”, me fond limit 4 940 000 (katër milion e nëntëqind e e dyzet mijë) lekë pa

TVSH, zhvilluar më datë 08.09.2025 nga autoriteti kontraktor, Shoqëria Rajonale Ujësjetellës Kanalizime Berat sh.a.

2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “2 AT” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Gjergj Mersini

Nënkryetar
Fiovent Zguro

